

Mirjana Mirçevska Jovanović

Jam i lumtur për festat, sepse atëherë gjyshja me siguri m'i përgatit ushqimet që i preferoj, vezë të skuqura, me virshlle, dhe ushqimin tim më të preferuar, qebapë. Ivani, djaloshi gjashtë vjeçare tregoi si do ta kalojë vitin e ri. Djali i cili para gjashtë muaj dëshiroi të provojë akullore në kornetë, askënd nuk e la indiferentë, sot sërish para kamerës së televizionit Kanal 5 i tregoi dëshirat, por edhe i falënderoi të gjithë ato që i ndihmuan. Nuk e harruan djaloshin e lezetshëm, një shikuese e televizionit tonë i dhuroi para si dhuratë për vitin e ri.

Ai ia dha paratë gjyshes që të blejë gjithçka që duhet, Për vitin e ri ai do t'i ndihmojë gjyshes Violeta për të përgatitur ushqimin.

-Unë di si të bëj. (Ivan)

E mësove recetën e gjyshes?

-Po. (Ivan)

Edhe si duhet?

-I vendon qebapët të skuqen dhe do të përgatiten. (Ivan)

Ku i vendon të skuqen?

-Në tavë. (Ivan)

Po në tavën çfarë vendon?

-Qebapët nga mishi. (Ivan)

Në shtëpinë e tyre gjithçka është modeste, i kanë dhuruar miqtë një bredhë dhe lampionë. Pas disa donacioneve shtëpia është rregulluar, kanë dritare të reja, pajisje shtëpiake, mobile, por ende ka lagështi.

Poshtë ende është beton, izolim nuk kemi dhe kërkojmë të paraqitet ndonjë dashamirë, së paku të na sigurojë poshtë. Unë kam dhënë dokumentet për ndihmë sociale, mirëpo paratë ende nuk m'i kanë dhënë. Më dhanë ndihmë të njëhershme, bleva krua, pjesë për shporetin dhe u harxhuan paratë.

Ivani si çdo fëmijë tjetër ka dëshirë për Babadimrin, ai dëshiron makinë me akumulatorë. Por, kjo është dëshira e tij e vërtetë.

-Dua babai im të vjen për vitin e ri. (Ivan)

A je takuar me babin?

-Po (Ivan)

Edhe? Çka i tha?

-E pyeta a do të vjen për vitin e ri. Ai më tha se nuk e di. (Ivan)

Babai i tij është në burgun në Idrizovë, për shkak të transportit ilegal të emigrantëve. Ivani dhe gjyshja e tij shpresojnë se do ta shohin për festat. Ivani jeton me xhaxhin dhe me gjyshen.

-Së paku të mund të vijë për fundjavë. (Gjyshja)

Sa e ka dënimin?

-Gjashtë vjet, aty është afër dy vjet e gjysmë. (Gjyshja)

Për çfarë arsye është aty?

-Për shkak të emigrantëve. (Gjyshja)

Ai shkon në klasë të parë dhe e do shkollën. Në këtë rast i përshëndeti shokët, por ka edhe një premtim për mësueset.

Çka të thonë mësueset?

-Më thonë të rri urtë. (Ivan)

Nuk je shumë i urtë?

-Po. (Ivan)

Çka bën?

-Vetëm luaj në bankën. (Ivan)

Do të premtosh se për vitin e ri do të jesh më i urtë?

-Po. (Ivan)

Mirjana Mirçevska Jovanović

Ivani, djaloshi gjashtë vjeçar me padurim e pret ditën e nesërme, 1 shtatorin. Ai do të shkojë në klasë të parë. Fëmija, jeta e të cilës askënd nuk e la indiferentë, çdo tridhjetë minuta e pyeste gjyshen edhe sa orë ka deri sa të dëgjojë zilen e shkollës. I vogël, por i mençur, duhet të mësoj që të punoj, tha ai.

-Dua të bëhem polic. (Ivan)

Pse dëshiron të bëhesh polic?

-Sepse të gjithë janë të këqij. (Ivan)

Edhe?

-Do t'i kapi. (Ivan)

Që të bëhen të mirë?

-Po. (Ivan)

Po në kohë të lirë, çfarë lodre dëshiron të dhurojnë?

-Dua makinë me akumulatorë. (Ivan)

Drejtori i shkollës "Tihomir Milloshevski" në Gjorçe Petrov, sot e mirëpriti në shkollë dhe i dhuroi çantë dhe mjete shkollore, që gjyshja e tij nuk kishte mundësi t'i blejë.

Atë që shkolla mund t'i premtojë Ivanit është se do të kujdeset për arsimin e tij të vazhdueshëm, kemi përgatitur për nxënësit e klasave të para të kësaj kategorie, diçka që do të jetë bazë për një fillim të mirë, dhuratë të vogël për nxënësin, ka mjete shkollore dhe çantë për në klasë të parë. Do të thotë shkolla do të mbulojë arsimin e tij të mëtutjeshëm në klasë të parë, ndërsa për më tutje do të merremi vesh.

Ivani, i lumtur sepse dy ditë më parë është përshëndetur me Liqenin e Ohrit. Ai për herë të parë ka shkuar në pushim, ka mësuar të notojë. Pushimi është donacion i organizatës "Milosrdie".

-Aty u lava dhe zhytesha, notova. (Ivan)

Kush të mësoi të notosh?

-Vet u mësova në pishinën e madhe, në të thellën. (Ivan)

Pas storjes së "Kanal 5" shumë njerëz human dhe firma iu ndihmuan Ivanit dhe gjyshes së tij Violeta. Ministria për punë dhe politikë sociale do t'ju jep ndihmë të njehershme prej 30,000 denarë, ndërsa qendra për punë sociale do t'ju jep 4,000 denarë. Ivani me donacionet është veshur nga koka deri te këmbët. I kanë dhuruar tablet dhe shumë lodra. Prej nesër shumë firma do ta rregullojnë shtëpinë e tyre të vjetër si dhe tualetin. Ndërsa Violeta është shumë e lumtur sepse firma "Makoil" e punësoi djalin e saj.

-Do të bëjnë izolim, të jashtëm dhe të brendshëm, edhe dhomë për Ivanin do të bëjnë. (Violeta)

Kur do ta bëjnë?

-Nuk e di. Alkaloidi do ta bën tualetin. Makoil do ta bën shtëpinë. Aty punon Nikola. Në Makoil filloi me punë, e paraqitën. Mirë është, thotë se e ka punën e mirë. Jam shumë e lumtur për të dhe për Ivanin. (Violeta)

Ivani jeton me gjyshen dhe xhaxhin e tij. Nëna e ka lënë ndërsa babai i tij është në burg. Qysh nga mosha më e re ka mësuar se jeta është e vështirë. Dritën që e kanë në shtëpi është për kohë të shkurtër, nëse nuk paguhen llogaritë, Ivani edhe më tutje do të han dhe do të shkruan nën dritën e qirit. Kur e takuam për herë të parë dëshiroi akullore. I preferon kornetat. Edhe sot sytë e tij shndritën. Ne i dëshirojmë fillim të mbarë në shkollë dhe ditë të ëmbla dhe plot me gëzim.

Mirjana Mirçevska Jovanović

Në shtëpi të vjetër dhe të rrënuar dhe me erë të lagështisë, sytë e gjalla dhe të mençura të djalit gjashtëvjeçarë Ivanit ju presin në dhomën e tyre, nga buzët e tij fillojnë të dalin tregimet për lodrat dhe dëshirat që i ka, ndërsa askush nuk mund t'ia plotësojë. Ai dëshiron dhomë për vete, tablet dhe kompjuter. Në këtë shtëpi jeton së bashku me gjyshen e tij dhe me xhaxhin e tij 18 vjeçar. 58 vjeçja Violeta me vite jeton duke u mbijetuar, me ndihmë të vajzës, fqinjëve, ndërsa edhe kisha katolike nuk i ka harruar. Moshë dhe reuma e kanë shty gjyshen të kërkojë ndihmë nëpërmjet të televizionit. Psherëtimat e rënda i ndërpreu me historinë e saj të jetës.

-Nëna e la, u rimartua. Prej kur ishte i vogël e ruaj unë, tani babai i tij është në burg në Idrizovë, për shkak të emigrantëve, është dënuar me tetë vjet burg. Nuk kemi të ardhura, fqinjët na japin për të ngrënë. (Violeta)

Me sa para jetoni në muaj?

-Po vajza na dërgon para nga Gostivari, ndonjëherë 500 ndonjëherë 1000 denarë. Kursejmë, ç'të bëjmë, kryesorja është ai të ketë për të ngrënë.

Rrymë nuk kanë afër një vjet, shkak i borxhit i cili është 320,000 denarë, ndërsa edhe ujin do t'ua ndalin së shpejti. Ndhimë sociale nuk pranon, nuk ka as pension. Drita e vetme është qiri, edhe atë e kursejnë, bën dritë vetëm kur darkon Ivani. Shpresa e vetme për të është djali 18 vjeçar, i cili ka mësuar për kuzhinier, të fillojë të punojë diku dhe të ndihmojnë ato të cilët mund t'ia rregullojnë shtëpinë e saj të rrënuar.

-Kërkon punë, kush mund të ndihmojë për punësim, ose për rrymën, për ujin. (Violeta)

Pension pse nuk merrni, keni 58 vjet?

-Nuk kam qenë e martuar me burrin, nuk donte të martohemi, jetonim bashkë për 20 vjet por nuk u martuam. Në bocën e vogël të gazit, aty gatuajmë diçka, që të hamë së shpejti. Skam, jetojmë në kushte të vështira. (Violeta)

Ivani është më i lumtur kur gjyshja i përgatit vezë të skuqura dhe virshlle. Kur rritet dëshiron të vozisë kamionin më të madh në botë.

-Nuk kam provuar akulllore në kornetë këto ditë. Mirëpo përpara kam provuar. Ka akulllore për 20 denar. (Ivan)

Gjyshja dhe nipi mbetën në shtëpi. Ajo shpreson se do të rritë Ivanin në kushte më të mira pa lagështi dhe pa insekte nën qilimin. Ndërsa Ivani premtoi se kur do të rritet do ta ruajë gjyshen e tij të vetme Violetën.